



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Mekanizmi Kombëtarë për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2014
Nr. Dok. 201401356/2

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve të trajtimit të të denuarve dhe të paraburgosurve në I.E.V.Penale "Jordan Misja", 313 Tiranë.*

Drejtuar: **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur Zoto**

**Drejtorit të I.E.V.Penale "Jordan Misja", 313
Z. Saimir Allushi**

TIRANË

Të nderuar Zotërinj,

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale "Jordan Misja" (313) në Tiranë më dt. 30.06.2014. Në përbërje të grupit inspektues bënë pjesë Alfred Koçobashi (drejtues i grupit inspektues), Irena Taga, Alma Alibali, N/Komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës së bashku me ekspertët e Shoqatës Përthyerje, në zbatim të marrveshjes së bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar Parandalues në kuadër të *OPCAT-it* me OJF të specializuar të fushës.

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të denuarve dhe paraburgosurve, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si vijon:

Me urdhër nr. 329, datë 15/01/2009, "Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale", të ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale "Jordan Misja" kategorizohet "Institucion Paraburgimi, me

një seksion paraburgimi për të mitur, me një seksion paraburgimi për gra, me një seksion paraburgimi për meshkuj. Kapaciteti maksimal i I.E.V.P-së është 320 persona.

Në këtë institucion strehohen të paraburgosur të mitur, të rritur dhe gra¹. Në kohën e monitorimit, në institucion ishin 543 persona të paraburgosur në total, nga të cilët, 32 të paraburgosur ishin minorenë, ndërsa 42 të tjerë ishin të paraburgosura femra. Përsa më sipër rezultoi që, në kohën e monitorimit të institucionit të I.E.V.P-së "Jordan Misja" (313), të ishin 469 të paraburgosur meshkuj të rritur dhe të rinj. Në institucion kishte mbipopullim dhe 15% e të dënuarve flinin në tokë me dyshekë; IEVP Jordan Misja është i përbërë nga 4 seksione: seksioni i paraburgimit burra, seksioni i paraburgimit gra, seksioni i të paraburgosurve të mitur dhe seksioni i vëzhgimit; Të paraburgosur që ishin të vecuar me masën disiplinore të vecimit ishte 1 dhe 1 i mitur ishte në pritje për të dalë në komisionin disiplinor; Kishte 9 të arrestuar me burg me probleme të shëndetit mendor, por nuk ekzistonte një seksion i vecantë; Në institucionin qëndronin të arrestuar me burg 7 shtetas të huaj, të cilët të gjithë kishin kontakte me përfaqësitë diplomatike të shteteve të tyre në Tiranë. Organika e stafit ishte e plotësuar.

Monitorimi u krye në seksionin e burrave i cili përbëhej nga 9 sektorë gjithashtu në atë të të miturve dhe grave. Objektivi i grupit monitorues në këtë vizitë pranë I.E.V.P.-së "Jordan Misja" (313) Tiranë ishte vlerësimi i kushteve dhe trajtimi i personave të paraburgosur dhe dënuar në këtë institucion.

Vizita monitoruese e stafit të MKPT-së pranë I.E.V.P.-së "Jordan Misja" (313) Tiranë, u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtori i Institucionit ekspertëve ju ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që do të monitoronin.

Shënime paraprake

Paraprakisht, nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve ju bë e ditur se, në aspektin material, pjesërisht, infrastruktura e institucionit ishte e vjetëruar, pavarësisht përpjekjeve për t'u rregulluar, por gjithmonë në mungesë fondesh për të ndërmarrë një iniciativë të tillë. Gjatë vizitës monitoruese pranë I.E.V.P. « Jordan Misja » (313) Tiranë, grupi monitorues i IET-së mori kontakt me stafin drejtues, atë mbështetës, mjekësor dhe atë të kujdesit social, ku u vlerësuan rregjistrat penitenciarë, kartelat mjekësore dhe dosjet psiko-sociale, si dhe u mblodh informacion mbi natyrën e aktiviteteve të zhvilluara nga stafi drejtues, mbështetës, mjekësor e ai psiko-social.

Grupi i monitorimit u fokusua në respektimin e të drejtave dhe lirive të të paraburgosurve, kushtet e trajtimi që u ofrohej këtyre, si dhe komponentë të tjerë që kishin të bënin me kontrollin mjekësor e atë të vlerësimit psiko-social.

Trajtimi i të paraburgosurve dhe masat mbrojtëse

Grupi monitorues u fokusua në evidentimin dhe vlerësimin e fakteve të mbledhura, si nga dëshmitë e të paraburgosurve duke krijuar kontakte personale e kolektive në privatësi të plotë, ashtu edhe nga bisedat e zhvilluara me vetë punonjës të institucionit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit

¹ Shiko për më tepër faqen zyrtare të DPBSH. : <http://www.dpbsb.gov.al>

përkatës lidhur me aspekte të përdorimit të forcës apo keqtrajtimi fizik e psikologjik, marrjen e masave disiplinore me veçim nga aktivitetet e përbashkëta, etj. Nga vëzhgimi dhe bisedat me të paraburgosurit, nga ana e tyre, përgjithësisht, u pohua raporti i mirë që ekzistonte ndërmjet tyre dhe forcave të ruajtjes së sigurisë në institucion, duke përjashtuar rastet e keqtrajtimit apo të ushtrimit të dhunës.

Nga monitorimi i dokumentacionit të të paraburgosurve në institucion, u vërejt se nga ana e institucionit dokumentacioni ishte konformë kërkesave të ligjit. Sipas dokumentacionit, të paraburgosurit pritës, kalonin në Komisionin e Pritjes dhe më pas mbaheshin në observim.

Ekzistonte dhe funksiononte rregullisht komisioni i marrjes së masave disiplinore për të paraburgosurit. Në kohën e monitorimit u konstatua vetëm një i paraburgosur, i cili vuante masëm disiplinore, atë të veçimit. I paraburgosuri Ergys Prifti, me masën disiplinore të vecimit për 20 ditë, që qëndronte në dhomën e vecimit, nuk kishte asnjë kopje të vendimit të komisionit disiplinor për masën e dhënë. Pas bisedës me të paraburgosurin dhe pas leximit të raportit të shërbimit për ngjarjen, vlerësojmë se masa e dhënë nuk ishte në përpjestim me shkeljen e kryer. Dhoma e vecimit nuk ishte e pastër dhe i paraburgosuri e hante ushqimin në tokë.

Nga vizita brenda në regjim u konstatua se ende nuk ekzistonte ndonjë sektor i veçantë për të paraburgosurit e rinj (18-21 vjeçarë), por këta të fundit bashkëjetonin në dhoma dhe kryenin aktivitetet e përbashkëta me të paraburgosurit e tjerë madhorët, ku në shumicën e rasteve këto bashkëjetesa ishin me pëlqimin ose me kërkesën e tyre. Në të gjitha seksionet mungonin kutitë e ankesave/kërkesave dhe të dënuarit ua dorëzonin ankesat/kërkesat edukatorëve të cilët administronin rregjistrin e kërkesë/ankesave të institucionit. Në të gjithë sektorët pihej duhan në të gjitha dhomat e banimit, gjë që dëmtonte shëndetin e të tjerëve dhe gjithashtu krijonte probleme të frymëmarrjes te të paraburgosurit. Problemi i lejimit të pirjes së duhanit në dhomat e banimit bëhet më shumë evident në sektorin e të miturve, gjë që duhet të zgjidhet në mënyrë urgjente duke ndaluar blerjen dhe pirjen e duhanit nga të miturit në këtë sektor shoqëruar me një fushatë ndërgjegjësuese për dëmet e duhanit.

Kushtet materiale

Nga grupi i monitorimit u monitorua edhe aspekti i repektimit të standarteve normale të jetesës. U pyetën të paraburgosurit mbi respektimin e këtyre kushteve, si dhe u vëzhguara në terren cilësia dhe standarti i tyre.

Mjediset e korridoreve, banjat, dushet dhe kuzhina e institucionit ishin të pastra dhe të higjenuara.

Kushtet e jetesës: së pari, vlen të theksohet, fakti i pranuar edhe nga përfaqësuesit e institucionit, që në institucion kishte mbipopullim të tejskajshëm. Kjo sillte shkeljen e standartit të sipërfaqes së banimit për banor në dhomë banimi ku shumica e të paraburgosurve banonin në më pak se 3m² dhe në disa raste dhe nën 2.2m² për person në dhomat me sipërfaqe 8.8m² ku akomodoheshin 8 persona.

Grupi monitorues, gjatë vizitës së tij, konstatoi raste të shumta kur të paraburgosurit nuk kishin shtretër dhe për pasojë flinin në tokë. Po kështu u

vërejt se në dhomën e observimit dhe veçimit mungonin tavolinat dhe karriket dhe të paraburgosurit në observim e konsumonin ushqimin në krevat ose në këmbë. Përsa i përket infrastrukturës, në përgjithësi, grupi i monitorimit arriti në konkluzionin se ambienti i institucionit të paraburgimit 313 është i vjetër dhe i amortizuar. Për të konkretizuar këtë konkluzion përmendim disa fakte si: dhomat e të paraburgosurve pa banjo dhe lavaman brenda, pasi këto të fundit së bashku edhe me dushet ishin të përbashkëta dhe në një gjendje jo të mirë materiale.

Përgjithësisht dritaret e dhomave ishin nën përmasat minimale të standartit të vendosur me akt normativ, me qëllim ndriçimin ambiental dhe ajrimin, etj.. *Rregjimi ushqimor:* ushqimi shërbehej në 3 vakte, në orare të caktuara. U monitorua edhe kuzhina, e cila ishte konformë kërkesave ligjore përsa i përket dokumentacionit dhe ruajtjes së kampioneve. Në kohën e monitorimit po përgatitej dreka. Kushtet higjienike në kuzhinë respektoheshin. Nga vizita në kuzhinën e institucionit rezultoi se ushqimi i përgatitur për vaktin e drekës ishte i cilësisë shumë të kënaqshme, mjedisi ishte shumë i pastër dhe i mirëmbajtur. *Higjena personale dhe shërbimet sanitare:* siç u përmend e më sipër, nga ekspertët u konstatua se qelitë ishin pa banjo brenda, dhe banjot ishin të përbashkëta në një ambient me dushet. Në qeli u konstatua mungesa e lavamaneve. Dushi realizohej sipas një grafiku, sipas të cilit një i paraburgosur kishte të drejtë të bënte dush 2 herë në javë, por që në realitet për shkak të amortizimit të dusheve, nga të paraburgosurit ekspertët u bënë me dije se ky standart nuk kishte mundësi të respektohej.

Kushtet e banjove dhe të dusheve ishin në gjendje të amortizuar, si dhe nuk sigurohej privatësia, pasi si dushet, ashtu edhe banjot ishin pa dyer ndarës. Përsa i përket furnizimit të të paraburgosurve me produkte të higjienës personale dhe të asaj të përbashkët, ekspertët u informuan nga vetë të paraburgosurit, por dhe u konstatuan nga monitorimi se, mungonin qeset e plehrave, detergjentët larës, shampo flokësh, pastë dhëmbësh, etj., dhe në rastet që u konstatuan produkte të tilla, sipas të paraburgosurve u ishin sjellë nga familjarët.

Regjimi dhe aktivitetet

Nga kontakti i ekspertëve me të paraburgosurit dhe sipas informacioneve të tyre u konstatua se si takimet me familjarët ashtu edhe telefonatat respektoheshin konformë kërkesave të legjisllacionit. Nuk pati ankesa për regjimin e telefonatave dhe të takimeve.

Në sektorin IV të të paraburgosurve burra, kishte mbipopullim, dhomat ishin të papërshtatshme. Të paraburgosurit në këtë sektor u ankuan se ndanin dhomat me të paraburgosur me probleme të Shëndetit Mendor, gjë që ishte një problem për ta sa i përket qetësisë dhe mirëkuptimit për bashkjetesën në dhoma. Të paraburgosurit në sektorë u ankuan për mungesën e ujit, mbipopullimin dhe fjetjen me dyshekë në tokë dhe ajrosjen e bërë vetëm 3 herë në javë. Gjithashtu të paraburgosurit u ankuan për dhomat e takimit me familjarët, që ishin të ndara me hekura.

Në lidhje me ajrimin, përvec bisedës me të paraburgosurit, u kërkua informacion nga stafi dhe rezultoi se në sektorin e të paraburgosurve burra nuk ishte e mundur të sigurohej ajrim në ajer të pastër cdo ditë, sigurohej ajrim 3 herë në javë 1 orë në ditë. Ajrimi është e drejtë e rëndësishme që garantohet nga Ligji “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me burgim dhe të Paraburgosurve” dhe duhet të sigurohet në cdo rast. Në dhomën e vecimit ndodhej prej 7 ditësh me masë disiplinore i paraburgosuri Ergys Prifti, i cili nuk ishte nxjerrë në ajrim asnjëherë, gjë që është shkelje e ligjit.

Orari i veprimeve në të gjithë institucionin ishte i njëjtë, që do të thotë se të dënuarit në seksionin e të paraburgosurve burra, sektori i të paraburgosurve gra, seksionit të paraburgimit për të miturit dhe seksionit të vëzhgimit i nënshtroheshin të njëjtit rregjim.

Nga takimi me stafin e sektorit të kujdesit social u informuam për aktivitetet dhe programet që zbatoheshin në institucion si dhe pamë me zgjedhje disa dosje psiko-sociale të të paraburgosurve të mitur. Punonjësit e sektorit të kujdesit social ishin brenda në të gjitha seksionet gjatë vizitës sonë dhe na shoqëruan përgjatë vizitës. Ata kishin programe individuale të trajtimit për të dënuarit si dhe organizonin aktivitete të përbashkëta me të dënuarit, kryesisht diskutime në grup për tema sociale dhe aktivitete sportive. Dosjet psiko-sociale të të miturve ishin të plotësuara në kohën e pritjes së të miturit, por kërkonin rifreskim me përmbledhje nga çdo takim me të paraburgosurit.

Grupi monitorues monitoroi edhe vendin e takimit me familjarët, i cili ishte i ndarë në dy pjesë, ku nga njëra anë hynin familjarët dhe nga ana tjetër rrinin të paraburgosurit. Këto dy pjesë ishin të ndara me zgarë hekuri dhe xham dhe të dyja anët ishin të pajisura me stola për t’u ulur. Ambienti ishte i papërshtatshëm për takim me familjarë të mitur.

Nga ana e institucionit ofrohej punësimi i të paraburgosurve në institucion, në kushte të kufizuara, sipas listës së punësimit të miratuar nga DPBSH. Një fakt i konstatuar nga ekspertët ishte se të paraburgosurit e punësuar nuk paguheshin për punën që bënin, si dhe nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe librezë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pra për pasojë ata nuk përfitonin kontributin shoqëror e shëndetësor.

Ato trajtoheshin vetëm me ulje dënimi, në rast se ata do të merrnin dënim. Në dispozicion të grupit monitorues u vu lista e personave të punësuar, prej ku u verifikuan emrat e të paraburgosurve që ishin të punësuar, por që nuk ishin në dijeni nëse rezultonin si të tillë. Të paraburgosurit e punësuar nuk firmosnin për ditët e tyre të punës dhe nuk kishin dijeni mbi përfitimet e tyre. Të tjerë të paraburgosur nuk kishin dijeni mbi mënyrën se si mund të përfshiheshin në organikën e punës.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale, u vu re se dosjet ishin të plota me informacion të përgjithshëm dhe në rastet e gjykuara të përshtatshme edhe me programe individuale trajtimi. Vijonin të mos përdroreshin testet diagnostikuese.

Seksioni i të miturve

Nga vizita në sektorin e të paraburgosurve të mitur, rezultoi se korridori dhe mjediset e përbashkëta ishin të pastra, por dhomat e të miturve ishin të pajisura në disa raste shumë varfër dhe dyshekët ishin të papërshtatshëm si dhe kishte

të mitur që nuk kishin çarcafë për fjetje. Disa prej të miturve qëndronin në dhomat e tyre, disa ishin në takim në bibliotekë me punonjësen sociale, ndërsa një dhomë ishte e mbyllur nga punonjësit e sigurisë me justifikimin se ata ishin përfshirë në një zënkë me të miturit e një dhome tjetër, ditën e shtunë (28 Qershor 2014, ora 13.30). Dhoma e aktiviteteve të përbashkëta dhe e TV ishte e mbyllur në orarin e vizitës monitoruese 09.00-13.00. Të miturit e përfshirë në këtë zënkë prisnin të dilnin në komision disiplinor, por deri në orën 14.00 të ditës së hënë, komisioni disiplinor nuk ishte mbledhur akoma. Ankesa e të miturve ishte kohëzgjatja e qëndrimit në arrest me burg, gjë që vinte si rrjedhim i vonësive në procesin e hetimit, edhe për akuza për vepra jo të dhunshme.

Seksioni i grave

Gjatë vizitës monitoruese, grupi i ekspertëve konstatoi amortizim të theksuar të të gjithë ambienteve të këtij sektori, me një mbipopullim i cili cenonte standardin për hapësirën jetike. Fillimisht grupi inspektues vizitoi dhomën e aktiviteteve e cila shërbente si bibliotekë, si dhomë këshillimi individuale ose në grup. Ajo gjithashtu shfrytëzohej për zhvillimin e kurseve informate të trajnimit për rrobaqepësi, parukeri, pikturë etj.

Aktualisht në këtë sektor ndodheshin 42 gra. Dhomat ishin të ftohta e me lagështirë, me një ndriçim natyral të pa mjaftueshëm. Në çdo dhomë ishin të akomoduar nga 4, 5, 7 gra në një hapësirë 2mx3m, ku në shumicën e rasteve flinin dy veta në një krevat.

Në këtë sektor kishte shumë ankesa jo vetëm për kushtet fizike dhe materiale, por edhe për një shërbim shumë të dobët kuzhine. Kushtet e banjave dhe dusheve ishin tejet të amortizuara me probleme në furnizimin me ujë.

Në të gjithë ambientet e këtij seksioni mungonin kutitë e ankesave/kërkesave dhe të dënuarat ua dorëzonin ankesat/kërkesat edukatorëve të cilët administronin regjistrin e kërkesë/ankesave të institucionit. Po ashtu, mungoni edhe posterat për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Shërbimet shëndetësore

Organika e këtij sektori përbëhej nga një mjekë, një stomatolog një farmacist, dhe ndihmës mjekë.

Nga bisedat me të dënuarat, grupi inspektues konstatoi se në këtë institucion ofrohej një shërbim shëndetësor përgjithësisht i mirë, i cili kishte mangësi për shkak të mbipopullimit, duke sjellë vonesa në kryerjen e vizitave apo të konsultave të domosdoshme nga specialistët në spital. Gjatë monitorimit u vë re se shumë ankesa kishte edhe për mungesën e medikamenteve si për raste urgjente ashtu edhe për sëmundje kronike. Nga stafi i këtij sektori, trajtoheshin 53 të sëmurë kronik, 12 të sëmurë mendorë, dhe 6 abuzues me substanca narkotike.

Ky institucion ishte i pajisur me autoambulancë, e cila ishte në funksion të plotë. Dhoma e mjekut, ku kryente vizitat megjithëse ishte e amortizuar, ajo mbahej e pastër e me rregull. Farmacia ishte e pastër dhe e kompletuar me medikamente, megjithëse nga të dënuarit e këtij institucioni morëm shumë ankesa në lidhje me ofrimin e medikamenteve sipas skemës së rimbursimit të ilaçeve. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me unit, autoklavë, por

mungonin instrumente e materiale dentare duke ofruar një shërbim të cunguar dentar, vetëm me ekstraksione.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash, themeltar i të sëmurëve kronike, regjistri për konsultat jashtë institucionit. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermiereve, gjithashtu. Kartelat mjekësore ishin të plotësuara në mënyrë korrekte, por nuk mbaheshin të mbyllura me çelës. Të gjithë të dënuarit ishin të pajisur me libreza shëndetësore. Një pjesë e vogël që ishin transferuar nga I EVP-të e tjera, prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me to.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të Ligjit Nr. 9888 dt. 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8328 dt. 16.04.1998 Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarave me burgim”* ku parashikohet midis të tjerash se: *“Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për mbylljen e këtij paraburgimi, si i papërshtatshëm me standartet e trajtimit të paraburgosurve të parashikuara në legjislacionin kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për të ulur mbipopullimin në institucion duke i garantuar të gjithë të paraburgosurve nga një krevat dhe hapsiren jetike të parashikuar në ligj.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin real të kushteve materiale në dhoma, banjo dhe ambiente të përbashkëta për të paraburgosurit.
4. Të merren masa për tu siguruar të paraburgosurve produktet e nevojshme për mbajtjen e higjenes në përputhje me standartet ligjore.

5. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e dhomave të observimit/vecimit me orenditë e nevojshme me qëllim përmbushjen e respektimit të dinjitetit të të paraburgosurve.
6. Të merren masa për të përshtatur ambiente e për të aktivizuar kurset profesionale e arsimore;
7. Të shtohet numri i konsultave të kryera nga mjeku psikiatër në përputhje me kërkesat e ligjit për shëndetin mendor.
8. Të merren masa për rregullimin e manaxhimit të procesit të kërkesë/ankesave, vendosjen e kutive në seksione dhe përcaktimin e një procedure për nxjerrjen e kërkesë/ankesave nga seksionet, rregjistrimin e tyre në rregjistër dhe manaxhimin e kthimit të përgjigjeve apo zgjidhjes së tyre brenda afateve të përcaktuara në ligj.
9. Akomodimin e të paraburgosurve me problem të shëndetit mendor në një seksion të vecantë.
10. Marrjen e masave për garantimin e të drejtës së të paraburgosurve për të pasur ajrim dhe aktivitete sportive në terren sipas parametrave ligjore çdo ditë, si dhe zbatimin e kësaj të drejte dhe për të paraburgosurit me masa disiplinore.
11. Marrjen e masave për respektimin e procedurës për komisionet disiplinore, procedurë që kërkon pajisjen e të paraburgosurit me një kopje të vendimit të komisionit si dhe informimin e tij për mundësinë e ankimit te drejtori i institucionit dhe/ose në gjykatë.
12. Nxjerrjen sa më të shpejtë të të paraburgosurve në komision disiplinor, nëse ka një raport shërbimi, sidomos në rastin e të miturve.
13. Marrjen e masave për të siguruar akses në dhomën e aktiviteteve ku ndodhet TV për të miturit që nuk kanë TV në dhoma, jo vetëm gjatë orarit të paradites por edhe për aktivitete pasdite.
14. Sigurimin e higjienës në dhomat e veçimit dhe ofrimin e shërbimeve në këto dhoma në mënyrë dinjitoze, pajisja e tyre me tavolina dhe stola.
15. Marrjen e masave urgjente për shtimin në organike e të paktën dy mjekteve të tjerë në sektorin shëndetësor.
16. Marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me medikamente të farmacisë së spitalit duke vënë në zbatim skemën e rimbursimit të ilaçeve.
17. Marrjen e masave të menjëhershme për rivlerësim, të diagnozës dhe mjekimit, të të dënuarve me sëmundje kronike dhe të dënuarve me probleme të shëndetit mendor.
18. Marrjen e masave për pajisjen e të gjithë të dënuarve me librezë shëndetësore, duke përshpejtuar procedurën e plotësimit me

dokumente përkatëse në rastet e transferimeve nga një IEVP në tjetrën.

19. Marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin e shërbimit stomatologjik me instrumente e materiale dentare

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në mungesë dhe me Porosi

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI